

## PROJEKT

### PER BASHKIMIN E SHOQERIVE "ALUSHQIP" sh.p.k ME "ALUMIL-ALBANIA" sh.p.k

Me vendimin Nr. 19911 date 17.08.1998, te Gjykates se Rrethit Tirane, eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregetare "Alumil-Albania" sh.p.k me seli ne Tirane. Ne baze te aktit te themelimit dhe statutit te saj si dhe te shteses se kapitalit me vendimin Nr 19911/1 ajo eshte krijuar dhe aktualisht jane kater ortak. Shoqeria anonime "Alumil-Milonas Aluminium Extrusion Industry Ae" me seli ne Zona Industriale Stavrohorio Kilkis - Greqi, e perfaqesuar nga zoti Georgio Mylonas, me kapital 94%, Georgios Mylonas me kapital 2%, Evangjelia Mylona me kapital 2% dhe Majlinda Kalludhi per vete dhe dy femijet e saj (trashjegimtare ligjore te ortakut Panajot Kalludhi) me kapital 2%. Kapitali themeltar i kesaj shoqerie eshte 270.000 \$.

Me vendimin Nr. 16209 date 29.06.1996 te Gjykates se Rrethit Tirane, eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregetare "ALUSHQIP" sh.p.k. Tirane me seli ne Tirane. Ne baze te aktit te themelimit dhe te statutit te saj si dhe te shteses se kapitalit themeltar me vendimin Nr. 16.209 /1 te Gjykates se Rrethit Tirane, eshte krijuar dhe aktualisht jane tre ortak. Jorgjios Salpingjidhis me 51% te kapitalit themeltar, Ioanis Buolios ne 24 % te kapitalit themeltar, Sotirios Buolios ne 25 % te kapitalit themeltar. Kapitali themeltar i kesaj shoqerie eshte ne shumen 8.949.000 leke.

Pas bisedimesh paraprake organet vendimore te dy shoqerive kane rene dakort per bashkimin e ketyre dy shoqerive ne kushtet e me poshteme :

- 1- Bashkimi do te kryhet ne formen e perthithjes ne te cilen Shoqeria "ALUMIL - ALBANIA" Sh.p.k. Tirane do te jete shoqeria perthithese dhe shoqeria "ALUSHQIP" Sh.p.k. Tirane do te jete shoqeria e perthithur.
- 2--Ortake te shoqerise se krijuar do te jene : Shoqeria Anonime "ALUMIL - MYLONAS, ALUMINIUM EXTRUSION INUSTRY AE " me seli ne Zona Industriale Stavrohorio Kilkis - Greqi, e perfaqesuar nga Z. Georgios Mylonas. Georgios Mylonas, Evangelia Mylona, Majlinda Kalludhi bashk me dy femijet e saj, si trashigimtar ligjor te Panajot Kalludhi, Jorgjios Sallpingjidhis, Ioanis Buolios dhe Stirios Buolios.
- 3 Emri i shoqerise se krijuar nga bashkimi do te jete "ALUMIL -ALBANIA" Sh.p.k.
- 4 Selia e shoqerise se krijuar do te jete po ajo e shoqerise "ALUMIL -ALBANIA" Sh.p.k.
- 5 Perqindjet e secilit ortak ne kapitalin e ri te krijuar nga bashkimi do te percaktohen pas paraqitjes se raportit nga eksperti kontabel ne mbledhjen e ardheshme te asamblese.
- 6 Administrator i kesaj shoqerie te krijuar nga bashkimi do te jete Georgios Mylonas